Vendim nr. 326, datë 12.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (F) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FLUTURAK SEJDARASI,** përfaqësuar nga avokati Besim Peka, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2267, datë 12.11.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-2929, datë 23.07.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit dhe përfaqësuesit të posaçëm të trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij, shtetasit Sh.S., në datën 24.06.2008, bazuar në ligjin nr.

9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*), i është drejtuar Zyrës Rajonale të Kthimit e Kompensimit të Pronave të Qarkut Korçë (*ZRKKP-ja, Korçë*), duke kërkuar njohjen e së drejtës të pronësisë dhe kthimin fizik të një sipërfaqeje toke "truall" prej 4.250 m², të ndodhur në Fshatin Vashtemi, Korçë.

2. ZRKKP-ja, Korçë, me vendimin nr. 751, datë 11.11.2008 (*vendimi nr. 751/2008*), ndër të tjera, ka vendosur: "Njohjen e së drejtës së pronësisë për pronën "truall" me sipërfaqe 4.065 m², të ndodhur në fshatin Vashtemi të rrethit Korçë, subjektit të shpronësuar Sh.S. (G.), trashëgimtarëve të tij ligjorë, të cilët, bazuar në dëshminë e trashëgimisë nr. 1051 rep. datë 07.10.1994, do të përfitojnë si me poshtë: H.S., Fluturak Sejdarasi, M.S. dhe A.S. secili nga 1/4 pjesë të pandarë [...], si dhe njohjen e së drejtës së kompensimit për pronën "truall" me sipërfaqe 990 m², të ndodhur po në fshatin Vashtemi të rrethit Korçë [...]". Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim, por ai është marrë në shqyrtim, kryesisht, nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (*AKKP*).

3. Në përfundim të shqyrtimit, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, bazuar në nenet 16/1 dhe 18/1 të ligjit nr. 9235/2004, me vendimin nr. 4381/6, datë 21.10.2009 (*vendimi nr. 4381/6/2009*), ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 751/2008 të ZRKKP-së, Korçë dhe kthimin për rishqyrtim në qark, duke lënë si detyrë administrimin e dokumentacionit ligjor (vendimi gjyqësor) në bazë të të cilit vërtetohet se Sh.S. është i njëjti person me shtetasin Sh.G. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë ankim/padi në gjykatë.

4. Nga ana tjetër, referuar asaj çka drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka konstatuar dhe lënë si detyrë në kuadër të rishqyrtimit të çështjes, rezulton që kërkuesi, në datën 23.11.2009, të këtë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë një kërkesëpadi, duke kërkuar "*konstatimin e pavërtetësisë së shënimeve në fletën e regjistrit të pronave bujqësore të fshatit Vashtemi, për vitin 1945, në nr. rendor të pronësisë 80, lidhur me mbiemrin e pronarit, nga "Goskova" si i pavërtetë, në "Sejdarasi" si i vërtetë"*. Lidhur me këtë kërkesëpadi të kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2010-107 (72), datë 12.01.2010, ka vendosur pranimin e saj. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 27.01.2010.

5. Ndërkohë, pavarësisht vendimit të AKKP-së nr. 4381/6/2009, çështja nuk rezulton të jetë rishqyrtuar nga ZRKKP-ja, Korçë, ashtu sikundër as nga vetë AKKP-ja pas suprimimit të zyrave rajonale të kthimit e kompensimit të pronave në qarqe, duke qenë ende dhe sot për rishqyrtim përpara vetë AKKP-së. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 4381/6/2009 të AKKP-së dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 751/2008 të ZRKKP-së, Korçë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3038, datë 04.03.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 4381/6/2009 të AKKP-së dhe rrëzimin e pjesës tjetër. Sipas gjykatës së shkallës së shkallës së parë, duke qenë se Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 27, datë 27.05.2010 (*vendimi nr. 27/2010*), ka shfuqizuar nenet 15, pika "1", shkronjat "c", "ç", "d", "dh" dhe 16 të ligjit nr. 9235/2004, dispozita këto mbi bazën e të cilave drejtori i përgjithshëm i AKKP-së kishte të drejtën e marrjes në shqyrtim, me iniciativën e tij, të vendimeve të dhëna prej ZRKKP-ve, vendimi nr. 4381/6/2009 i AKKP-së përbën një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, të dhënë në mungesë të bazës ligjore. Në vendimmarrjen e saj gjykata e shkallës së parë i është referuar edhe nenit 76, pikat 1 dhe 2, të Ligjit Organik të Gjykatës (në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes), sipas të cilit vendimi i Gjykatës që ka shfuqizuar një ligj ose akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull, sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi (pika 1) dhe se ai (vendimi) ka fuqi prapavepruese vetëm: a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar; b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë; c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit ose aktit normativ të shfuqizuar (pika 2). Për sa i përket kërkimit në pjesën e dytë të objektit të kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar atë të pabazuar, për sa kohë që nga AKKP-ja konfirmohet fakti se dosja e kërkuesit është pranë këtij institucioni, në pritje të një vendimmarrjeje nga ana e tij. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim AKKP-ja.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2267, datë 12.11.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3038, datë 04.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi është marrë në vlerësim të gabuar të provave dhe në zbatim jo të drejtë të ligjit. Sipas gjykatës së apelit, përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë se vendimi nr. 4381/6/2009 i AKKP-së është marrë në kapërcim të kompetencave të saj ligjore, është i pabazuar ligjërisht, për sa kohë vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk mund të këtë zbatim në rastin konkret, si rrjedhojë e mospasjes fuqi prapavepruese në këtë rast, referuar nenit 76, pika 2, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit "vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që gjykohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë", në rrethanat kur çështja gjyqësore objekt gjykimi nuk ka qenë në shqyrtim e sipër përpara gjykatës së shkallës së parë në momentin e marrjes dhe hyrjes në fuqi të vendimit nr. 27/2010, por, përkundrazi, ajo është iniciuar pas më shumë se 3 vjetëve. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2929, datë 23.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas Kolegjit Civil, nga gjykatat më të ulëta janë respektuar normat procedurale dhe nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve; janë respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor dhe vendimi i gjykatës së apelit nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po sipas Kolegjit Civil, gjykata e apelit ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen dhe ka kryer një analizë juridike të plotë të provave, duke e zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në vlerësimin e Kolegjit Civil, gjykata e shkallës së parë ka shfuqizuar vendimin nr. 4381/6/2009 të AKKP-së duke e zbatuar me fuqi prapavepruese vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës, gjë që bie ndesh me nenin 76, pika 2, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, për shkak se vendimi nr. 4381/6/2009 është marrë në kohën kur ligji ishte në fuqi dhe kishte sjellë efekte zbatuese, pasi ai jo vetëm nuk ishte ankimuar në gjykatë brenda 30 ditëve nga dhënia e tij, sipas nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, por çështja e njohjes së pronësisë në favor të palës paditëse (kërkuesit) ishte për shqyrtim në ZRKKP-të dhe pala paditëse kishte realizuar detyrat e caktuara për sigurimin e provave të tjera sipas vendimit të drejtorit të AKKP-së.

9. Për rrjedhojë, Kolegji Civil ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në interpretim të drejtë të ligjit, ndërsa ai i gjykatës së shkallës së parë është një vendim alogjik dhe që bie ndesh me shkakun për të cilin është ngritur kërkesëpadia. Sipas Kolegjit Civil, gjykata e shkallës së parë, nga njëra anë, shfuqizon vendimin e AKKP-së që ka shfuqizuar vendimin e ZRKKP-së dhe, nga ana tjetër, njeh fuqinë zbatuese të tij, pasi ligjëron vijimin e procesit administrativ të njohjes së pronësisë, duke rrëzuar padinë e paditësit për pjesën e kërkimit për të lënë në fuqi vendimin e mëparshëm të ZRKKP-së. Po sipas Kolegjit Civil, paditësi (kërkuesi) nuk ka bërë ankim ndaj kësaj pjese të vendimit dhe ky qëndrim i tij çon në dekadencë pretendimet e ngritura në rekurs se vendimi i ZRKKP-së ka marrë formë të prerë, pasi drejtori nuk ka ushtruar kompetencat e tij për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit të zyrës rajonale brenda 30 ditëve. Po ashtu, Kolegji Civil ka arsyetuar se sipas gjykatës së shkallës së parë jo vetëm që nuk është pranuar ky pretendim i paditësit, por përkundrazi është pranuar juridiksioni administrativ i rishqyrtimit të kërkesës për njohje pronësie në zbatim të vendimit të drejtorit. Për rrjedhojë, sipas Kolegjit Civil, pretendimet e ngritura në rekurs nga paditësi jo vetëm tejkalojnë shkakun ligjor mbi të cilin gjykata e shkallës së parë ka pranuar

padinë, por kanë rënë në dekadencë në zbatim të neneve 459 e vijues e 472 të KPC-së, për shkak se paditësi nuk e ka ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar pretendimet e tij për këtë pjesë.

10. Në datën 03.06.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 12.06.2026.

11. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se janë cenuar:

12.1. *E drejta e pronës dhe parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykata e apelit ka interpretuar në mënyrë të kufizuar fuqinë e vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, duke injoruar faktin se ligjshmëria e një akti administrativ duhet të vlerësohet jo vetëm në dritën e antikushtetutshmërisë së ligjit, por mbi të gjitha në lidhje me afatet prekluzive që ligji i kohës vendoste për administratën. Referuar praktikës gjyqësore, pavlefshmëria absolute nuk parashkruhet dhe nuk lidhet me afatet e ngritjes së padisë. Nëse drejtori i AKKP-së ka vepruar pa ligj, vendimi nr. 4381/6/2009 nuk ka ekzistuar kurrë juridikisht, pavarësisht ngritjes së padisë.

12.2. *E drejta e aksesit*, pasi rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, por Kolegji Civil ka vlerësuar se ai nuk i përmbante ato. Në rekurs janë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material, shkelje të rënda të normave procedurale dhe në kundërshtim me vendimet unifikuese. Kolegji Civil ka lënë pa korrigjuar procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykata e apelit.

12.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për pretendimet e kërkuesit. Ky i fundit ka pretenduar se vendimi nr. 4381/6/2009 i AKKP-së është nxjerrë në tejkalim të kompetencave dhe afateve të parashikuara nga ligji nr. 9235/2004, ndërsa gjykata e apelit e ka rrëzuar kërkesëpadinë bazuar në dy shkaqe, kompetencën e juridiksionit civil dhe prapaveprueshmërinë e ligjit. Vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, pranon se

çështja është civile, por, nga ana tjetër, nuk shqyrton nëse kërkuesi është pronar ose jo.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

15. Një nga kriteret paraprake për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual është ai i *shterimit të mjeteve juridike efektive*. Në lidhje me këtë kriter, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai nënkupton në aspektin formal që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës, ndërsa në aspektin substancial që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha shkallët e gjykimit, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, konkretisht në rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar prej tij (kërkuesit), Kolegji konstaton se pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e apelit dhe argumentet mbi të cilat ai mbështet këtë pretendim, nuk i ka ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Në këtë drejtim konsiderohet se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës për këtë pretendim, prandaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Për më tepër, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ky pretendim i tij rezulton dhe haptazi i pabazuar, pasi referuar vendimit të gjykatës së apelit të kundërshtuar prej tij, Kolegji vëren se vendimi i asaj gjykate plotëson kriteret minimale ligjore të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Ai nuk rezulton të ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar, si dhe nuk rezulton kontradiktor ose alogjik në përmbajtjen e tij. Me vendimin e saj, gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje në thelb pretendimit të kërkuesit të ngritur në objektin e kërkesëpadisë së tij, në lidhje me pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 4381/6/2009 të AKKP-së.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së *drejtës së pronës* dhe *parimit të sigurisë juridike*, pasi, sipas tij, gjykata e apelit ka interpretuar në mënyrë të kufizuar fuqinë e vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës. Po sipas kërkuesit, referuar praktikës gjyqësore, pavlefshmëria absolute nuk parashkruhet dhe nuk lidhet me afatet e ngritjes së padisë.

19. Gjykata ka pohuar se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose kur ai është i tillë sa e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 12, datë 12.02.2026; nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më lart, referuar argumenteve të sjella nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e së *drejtës së pronës* dhe *parimit të sigurisë juridike*, Kolegji vëren se ato kanë qenë objekt shqyrtimi edhe nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar (*shih paragrafët 7-9 të vendimit*), arsyetime të cilat, në vlerësimin

e Kolegjit, nuk rezultojnë arbitrare ose të paarsyeshme dhe nuk kanë çuar në një rezultat që e bën gjykimin të padrejtë në kuptimin kushtetues. Për këtë arsye, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

21. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së aksesit*, me argumentin se edhe pse rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil ka vlerësuar se ai nuk i përmbante ato.

22. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 77, datë 23.06.2026; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 77, datë 23.06.2026; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Sipas jurisprudencës kushtetuese, vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe arsyetimi të shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sipas nenit 485, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i këtij kodi. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Po ashtu, referuar vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar nga kërkuesi, Kolegji evidenton se ai kolegj e ka arsyetuar vendimin e tij edhe në drejtim të shkaqeve kryesore të ngritura në rekurs, duke mos u mjaftuar vetëm me arsyetimin e kufizuar të vendimeve të mospranimit, por duke u dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuesit të ngritura në rekurs (*shih paragrafët 8-9 të vendimit*). Për rrjedhojë, duke pasur parasysh natyrën seleksionuese të shqyrtimit në dhomën e këshillimit, si dhe faktin se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vlerësimin e

shkaqeve të rekursit nuk duket arbitrar dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, Kolegji arrin në përfundimin se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me legjislacionin procedural. Vetëm fakti që ajo ka vendosur mospranimin e rekursit nuk mund të vërë në dyshim të drejtën e kërkuesit për akses në atë gjykatë. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se argumenti i sjellë nga kërkuesi nuk mbështet pretendimin e tij për cenimin e së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "a", d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.